



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.293/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore: Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se postereve në afërsi të qendrës së votimit 100metra, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) Anr.293/2019 e datës 05.10.2019, me të cilin ka kërkuar që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës t'i shqiptohet gjobë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes- vendosjes së posterit të kandidatit të tyre për deputet Uran Ismajli në ditën e votimit në një perimetër më afër se 100 metra distancë nga Qendra e Votimit është pretenduar se kandidati për deputet Uran Ismajli, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka vazhduar me vendosjen e posterave në afërsi të qendrës së votimit, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me datën 05.10.2019, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 5 Tetor 2019, në afërsi me pak se 100 metra afër Qendrës së Vendvotimit, Sallës “1 Tetori”, mund të shihet, posteri i kandidatit për deputet Uran Ismajli, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).
Më këtë rast pretendohet se një gjë e tillë bie ndesh me Ligjin e Zgjedhjeve, rregullat zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes së partive politike të cilat të cilat qartazi parashohin se 24 orë para zgjedhjeve, të gjitha materialet/posteret propagandistike duhet të hiqen në rast se ndodhen në afërsi prej 100 metrave nga ndonjë Qendër e Vendvotimit.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografit, të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nuk është kontestues fakti se përmes fotografisë së dërguar si provë vërehet poster i kandidatit për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës, i vendosur vendin e dedikuar për reklama/poster.

Paneli vlerëson se në bazë të fotografisë së prezantuar si provë materiale, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siç përcaktohet me nenin 117 parag.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, ashtu që në afërsi të Qendrës së Votimit në një distancë më të afërt se 100 metra është i vendosur poster i kandidatit të Partisë Demokratike z.Uran Ismajli.

Në fotografi shihet vetëm poster i ndërsa qendra e votimit nuk shihet, nuk ka mundësi nga një fotografi e tillë të identifikohet qendra e votimit, dhe si rrjedhojë në pamundësi të identifikimit të qendrës së votimit, është e pamundur të përcaktohet distanca e kërkuar me ligj.

Po ashtu nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë dhe bindëse se është Salla "1 Tetori", dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për të votuar si Qendër e Votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.293 /2019 më datën 06.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Adnan Komushexhi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.